



ANGJELINA VUKSANI

DOKTOR I SHKENCAVE

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Dr. Angjelina Vuksani është pedagoge pranë Departamentit të Ekonomisë, Siper marrjes dhe Finances

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Operatorët e Biznesit

EMAIL

a.vuksani@umb.edu.al

BIO

Angjelina Vuksani ka përfunduar studimet e larta (diplomë e integruar) në Fakultetin e Ekonomisë dhe Politikave Agrare dhe Fakultetin e Inxhinierisë Pyjore në "Universitetin Bujqësor të Tiranës". Në vitin 2015 ka fituar gradën shkencore "Doktor" në "Universitetin Bujqësor të Tiranës" me rezultate të shkëlqyera.

Doktor Vuksani ka një karrierë të pasur në administratën publike, si drejtuese e Departamentit të Vlerësimit të Riskut në Agjencinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR). Gjatë karrierës së saj profesionale ka kontribuar në themelimin dhe konsolidimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU), si drejtuese e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut.

Në kuadër të procesit të integritit evropian ka drejtuar grupin për përgatitjen e raporteve periodike për progres-raportet BE- Shqipëri, në lidhje me kapitullin 12, të cilat janë paraqitur në Bruksel pranë DG SANCO.

Prej vitit 2014 është angazhuar si pedagoge e ftuar në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, si edhe në Fakultetin e Bioteknologjisë dhe Ushqimit.

Dr. Vuksani ka një kontribut të konsiderueshëm në fushën kërkimore-shkencore si autore e dhjetra artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit, disa prej të cilave me faktor impakti, si dhe botime e pjesëmarrje në dhjetra konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Zotëron gjuhën angleze.